



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:264125

Datë: 02.02.2024

Numri i dokumentit: 05280995

E.nr.402/11

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K... Sh.a, Prishtinë, kundër debitorit Sh.S nga Vushtrria, për pagimin e borxhit, jashtë seance, me datën 02.02.2024, e mori këtë:

A K T V E N D I M

I.HUDHET propozimi për përmbarim i kreditorit K... Sh.a, kundër debitorit Sh.S nga Vushtrria, për pagimin e borxhit në shumën prej 2113,18 euro.

II.Secila palë bart shpenzimet e veta të procedurës përmbarimore.

A r s y e t i m

Kreditori K..., Sh.a, Prishtinë, me datën 24.10.2011, ka parashtruar propozim për ekzekutimin e borxhit në lartësi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për periudhën kohore gjerë me datën 20.09.2011, kundër debitorit si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me konkluzionin e datës 18.12.2023, gjykata e ka thirrë kreditorin, që në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimit të konkluzionit, ndër të tjera që ta njoftoj gjykatën për borxhin aktual të debitorit, precizimin e periudhës kohore kur e kërkon borxhin kreditori, shumën e saktë të borxhit aktual të debitorit, numrin personal të debitorit, në kpoje të mjaftueshme propozimin për përmbarim me qëllim që të paiset debitori, kartelen financiare të konsumatorit në origjinal apo të vërtetuar, nën kërcënimin e pasojave procedurale nga neni 102 par.3 të LPK-së lidhur me nenin 38 të LPP-së. Kreditori me datën 28.12.2023, e ka pranuar konkluzionin e gjykatës si më lart, ndërsa me parashtrësën e datës 03.01.2024, ka theksuar se do të deklarohen kur të mbahet seanca gjyqësore, sepse e kanë të pamundur aktualisht.

Ligji për Procedurën Përmbarimore, konkretisht nenit 20 par.1 përcakton se “Në procedurën përmbarimore organi përmbarues vepron në bazë të parashtrësave të palëve dhe dëshmimeve tjera të dokumentuara.

Meqenëse, kreditori as pas konkluzionit të gjykatës, nuk ka vepruar në pajtim me konkluzionin e lartcekur të gjykatës, gjykata konform nenit 17 të Ligjit për procedurën Përmbarimore, ku përcaktohet “Në procedurën përmbarimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër” dhe dispozitës ligjore të nenit 102 par.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore i cili parasheh “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar,

parashtrësa do të hidhet poshtë.”, nenin 38 par.2 të LPP-së, lidhur me nenin 102 par.3 të LPK-së dhe 452 të këtij ligji, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gj y q t a r i
Izet Gërguri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga marrja të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.